**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA LUSHNJE**

Nr.5106/1 prot. Lushnje, më 17/06/2025

**PROJEKT-VENDIM**

**NR. 54 DATË 17/06/2025**

**PËR MIRATIMIN E VLERËS SË ANKANDIT NË 11 261 652,80 (NJËMBËDHJETË MILION E DYQIND E GJASHTËDHJETË E NJË MIJË E GJASHTËQIND E PESËDHJETË E DY PRESJE TETËDHJETË) LEKË, MINUS 20% NGA *VLERA FILLESTARE* PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË "KLUBI I FUTBOLLIT LUSHNJA 1930"SH.A**

Këshilli Bashkiak Lushnje, në mbledhjen e datës___/___/2025, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Njësia e Ankandit, në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 shkkronja a, neni 22 pika 1 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjne Vendore". Neni 120, neni 135 pika 2 shkronja "ë", pika 3, neni 145 pika 2, neni 187 pika 1 shkronja "b", neni 217, neni 229 pika 2 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, neni 21, neni 22, neni 34 të ligjit nr. 79/2017 "Për Sportin" i ndryshuar me ligjin nr. 105/2020 datë 29.07.2020. Neni 13 shkronja "i", neni 22,neni 40 Statuti "Klubi i Futbollit Lushnja 1930" sh.a dhe rekomindimit të Auditimit me nr. 919 datë 31.01.2024 të Kontrrollit të Lartë të Shtetit, Në zbatim të VKM -së nr.1719 dt.17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik" të ndyshuar, Kreu VI Kushte të Përgjithshme për zbatim, pika 6" Mungesa e Konkurrencës", shkronja c, VKB-Lushnje nr. 92 datë 30.09.2024, Autoriteti shitës bënë ndryshimin e vlerës duke e ulur në masën 20%. **JU**:

**PROPOZOJMË:**

1. Të miratohet Vlera e ankandit në **11 261 652,80 (njëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy presje tetëdhjetë ) Leke minus 20%** nga *Vlera fillestare e ankandit që ishte 14 077 066 ( katërmbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e shtate mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.* për privatizimin e shoqërisë "Klubi i Futbollit Lushnja 1930"sh.a.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Njësia e Ankandit.

**DREJTORIA JURIDIKE**
**BEDRI HIDA**

**KRYETARI I BASHKISË**
**ERISELDA SEFA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagjia "Kongresi I Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com